



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 20 dhjetor 2021

Takimi filloi në orën 10:05.

Takimin e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 50 - bashkëngjitur lista e pjesëmarrësve), ushtruesi i detyrës së Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, si dhe përfaqësues të mjeteve të informimit dhe OJQ-ve.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim.

Takimi është thirrur duke iu referuar dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimit Administrativ përkatës si dhe Statutit të Komunës dhe ka për qëllim që Ju të jeni të informuar lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve dhe të aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2021. Në këtë takim si temë është paraparë:

Tema: Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2021

Qëllimi i këtij takimi është realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të komunës së Podujevës të cilat janë paraparë për vitin 2021. Nga secila drejtori do të prezantoj disa prej aktiviteteve dhe punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2021.

Në Drejtorinë e Administratës në pika të shkurtra po i përmendi punët dhe aktivitetet që janë ndërlidh me këtë drejtori, kemi premtuar se do të krijojmë një orar lëvizës që do t'ju shërbej qytetarëve edhe gjatë orarit të pauzës dhe ky premtim është realizuar tani e një vit, qytetarët kanë mundësi t'i kryejnë shërbimet e tyre në Administratën komunale qoftë në ora 12:00 apo mes orës 12:00-13:00, e që kohë më parë gjatë kësaj periudhe kohore qytetarëve iu është dashur të presin, kurse tani ne kemi krijuar orarin lëvizës dhe qytetarët mund t'i kryejnë gjitha shërbimet e tyre. Kemi aktivizuar projektin Alo Komuna, platformë e cila iu ka mundësuar qytetarëve që në kohë reale t'i lajmërojnë ankesat dhe problemet të cilat mund të ndodhin në lokalitetet e tyre, gjatë kësaj kohe është bërë edhe mbulimi i qytetit me valët e internetit (WI FI), pastaj është realizuar sistemi i pritjes në radhë për shërbime më cilësore për qytetarët. Ka filluar realizimi i projektit one stop shop, ku të gjitha shërbimet mund të merren në një vend. Është bërë lejimi i hapësirës së oborrit të Komunës për t'ju shërbyer gjatë pushimeve bashkatdhetarëve tanë, kemi arritur ti vendosim 4 E-Kioske, në qytet dhe fshatra të cilat punojnë 24h, 7 ditë të javës. Është bërë renovimi i gjendjes civile në fshatin Herticë, kemi bërë marrëveshje me postën e Kosovës që shërbimet e pagesës të bëhen brenda objektit të Komunës.

Në drejtorinë e Buxhetit dhe Financave është bërë platforma e E-Shpenzimeve përmes së cilës shpenzimet e Komunës pasqyrohen në Ueb Faqe dhe gjithçka është transparente sa i përket shpenzimit të parasë publike që një gjë e tillë i ka munguar Komunës së Podujevës. Sa i përket të hyrave vetanake për këtë periudhë kohore kemi pasur tejkalim të parashikuar për vitin 2021, realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë në vlerë rreth 700,000.00 €, që është prej realizimeve më të mira që kemi pasur ndonjëherë në këtë sektor. Ajo që është më e rëndësishme gjatë kësaj periudhe kohore është bërë regjistrimi i tatimit në pronë të pronave të

cilat nuk kanë qenë të regjistruara më parë, fatkeqësisht është një proces të cilin ne e kemi gjetur në një gjendje jashtëzakonisht të keqe. Një numër i madh i bizneseve të cilat kanë bërë qarkullime të mëdha nuk kanë qenë të regjistruara për gjatë këtyre 20 viteve, arsyen mund ta dinë ata pse i kanë lënë. Ne kemi arritur ta përmbyllim me sukses këtë proces dhe të gjitha këto biznese janë futur në listën e tatim paguesve, sepse nëse kemi arritur të realizojmë tatimin në pronë të ndonjë qytetari të varfër ose e kemi kushtëzuar për marrjen e vërtetimit të tatimit në pronë për një pagesë simbolike për objektin e banimit, kurse ta lirojmë një biznes që ka pasur qarkullim vjetor të lart këtu nuk ka qenë në rregull dhe ne faktikisht e kemi rregulluar këtë çështje prandaj kemi këtë shifër të të hyrave vetanake gjatë këtij viti.

Drejtorja e Arsimit ka qenë fusha ku janë kryer shumë aktivitete siç është shpërndarja e 112 titujve nëpër shkolla me 30000 ekzemplarë në vlerë rreth 50,000.00 €, pastaj ndërtimi i fushave sportive në SHFMU “Shefki Kuleta”, në fshatin Bellopojë, SHFMU “Shefki Latifi” në fshatin Pollatë dhe në SHFMU “Enver Maloku” në Podujevë. Investime në efikasitet në SHFMU “Shaban Shala” dhe në SHFMU “Shefki Kuleta”, në fshatin Bellopojë. Kemi nda bursa për nxënës dhe studentë në vlerë 52,800.00 €, kemi furnizuar me kabinate të informatikës 20 shkolla, pajisja me laboratorë për lëndët fizikë, kimi, biologji për 20 shkolla në vlerë 250,000.00 €, fillimi i renovimit të çerdhes së dytë publike për fëmijë me kosto të projektit 100,000.00€, pastaj përmirësimi i infrastrukturës publike nëpër shkolla si dhe renovimi i ambienteve të brendshme nëpër shkolla. Vazhdimi i ndërtimit të shkollës “Ali Ajeti” në fshatin Ballofc. Marrëveshje bashkëpunimit me kompanitë “Sante Farm” dhe “Sante Fruit”, për punë praktike për nxënësit e shkollës së mesme të lartë ekonomike “Isa Boletini”, Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Podujevës dhe Caritasit Zviceran për fushën e edukimit para fillor në vlerë 12,500.00€, gjithashtu kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi në fushën e shkollave profesionale me Komunën Kestel në Turqi, është bërë shpërndarja e 21 fotokopjuesve multifunksional nëpër shkolla dhe furnizimi me 60 TV monitor në shkolla.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është drejtori e cila është ballafaquar me një numër të madh problemesh ku për një periudhë relativisht të gjatë kohore është dashur të fokusohemi në këtë drejtori ku një pjesë e shërbimeve të drejtorisë ka pasur një ngritje gjatë kësaj periudhe kohore por jo në atë nivelin e duhur apo të kënaqshëm të cilin ne faktikisht pretendojmë, sepse ende mbetet për të punuar në këtë fushë dhe besoj se rezultatet tani janë të arritshme dhe presim që në të ardhmen këto rezultate të thellohen që të kemi një institucion më të mirë në shërbim të qytetarëve tanë. Në qendrën anti covid kemi bërë zgjerimin e hapësirës ku ajo hapësirë ka qenë vetëm me 4 shtretër ku janë ofruar shërbime për personat e infektuar me virusin covid-19 dhe për personat tjerë të cilët kanë marrë shërbime mjekësore në të njëjtin vend ku si pasojë ka mundur që numri i rasteve të reja me virusin covid-19 të rritet, andaj ne është dashur të veprojmë dhe i kemi ndarë pacientët e dyshuar dhe ata të infektuar dhe shërbimet mjekësore janë ofruar në vende të ndara. Kemi aktivizuar një shërbim i cili i ka munguar Komunës tonë, është fjala për shërbimin në shtëpi për pacientët të cilët kanë nevojë për shërbime mjekësore, kemi funksionalizuar ultrazërin në vlerë 24,000.00€, në repartin e maternitetit dhe kështu i kemi eliminuar terminet e gjata për pritje, kemi funksionalizuar laboratorin viro-bakterologjik, me anë të cilit zbulohet bacili i tuberkulozit, është bërë edhe funksionalizimi i analizave Ddmer, Crs, dhe Astro. Në kuadër të kësaj drejtorie është bërë ndërtimi i 6 shtëpive në “Lagjen e Dëshmorëve”, në proces e sipër është ndërtimi i AMF-së, në fshatin Dobërdol si dhe në proces është ndërtimi i AMF-së në fshatin Lluzhan që është donacion, disa ditë më parë është nënshkruar memorandum bashkëpunimi për ndërtimin e Ambulancës së re në fshatin Gllamnik gjithashtu është bërë funksionalizimi i aparaturës për spirometri. Nga kjo drejtori janë ndihmuar 329 familje me subvencione për blerjen e barërave në vlerë 41,050.00€, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, për ndërtimin e 15 shtëpive ku Komuna merre për sipër participimin për pjesën e saj, gjithashtu është siguruar donacion nga shoqata “Shqiptarët për

Shqiptarët”, për ndërtimin e një lagjeje me kushte shumë të përshtatshme banimi për familjet në nevojë, kostoja e këtij projekti është rreth 1,000,000.00€, është bërë kompletimi i repartit të stomatologjisë me dy karrige stomatologjike moderne, po ashtu kemi siguruar shumë donacione me ndihma të ndryshme me artikuj ushqimor, veshmbathje, jorgan, e batanije për familjet në nevojë. Është bërë funksionalizimi i aparaturës laboratorike Ers Vital 100 për realizimin e 100 mostrave të sendimentacionit, gjithashtu është bërë funksionalizimi i mamografit, kemi filluar punën me dy ndërrime në QMF_të e fshatrave Orllan dhe Kërpimeh, ku këto dy qendra tani e 20 vite sipas dokumentacionit kanë punuar në dy ndërrime por kjo nuk ka zgjatur më shumë se dy javë pas zgjedhjeve. Kemi bërë renovimin e një numri të madh të QMF-ve dhe AMF-ve si dhe kemi subvencionuar një numër të madh të OJQ-ve.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, vlen të ceket përmbyllja e suksesshme e punimeve të sheshit në fazën e dytë me këtë rast edhe përmbyllja e përgjithshme e këtij projekti ku ky projekt ka përfunduar me një intensitet më të përsheptuar dhe fatmirësisht është përmbyll në mënyrë të suksesshme. Janë pajisur me leje personat fizikë dhe personat juridik, është bërë ndërtimi i platosë së parkingut dhe hapësirës gjelbëruese te objekti i Komunës së vjetër, me kosto të projektit 31,000.00€. Asfaltimi i rrugëve është bërë në gjatësi mbi 40 km, gjithsejtë 253 rrugë janë asfaltuar vlera e të cilave është më shumë se 2,000,000.00€. Është bërë meremetimi i objekteve banesore në kosto mbi 200,000.00€, si dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në kosto mbi 200,000.00€, është bërë raportimi i legalizimeve, ku numri i aplikantëve ka qenë 220, prej tyre 185 janë shqyrtuar. Harta Zonale është në përmbyllje të procesit, jemi duke pritur këto ditë pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe këtë projekt do ta sjellim para Kuvendarëve dhe do ta hedhim në votim natyrisht nëse arrijmë ta funksionalizojmë Kuvendin sepse deri më tani Kuvendi është jo funksional për shkak se nuk është zgjedh ende Kryesuesi i Kuvendit.

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, ka bërë evidentimin e të gjitha pronave komunale me qëllim të aktivizimit të kapitalit financiar. Kemi pas një varg pronash të cilat kanë qenë me potenciale të mira për të dhënë në shfrytëzim bizneseve të ndryshme, por të cilat fatkeqësisht nuk janë dhënë prandaj ne e kemi zhbllokuar këtë proces këtë vit dhe shpresojmë se vitin e ardhshëm do ta rrisim numrin e dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave në mënyrë që bizneset dhe investitorët e interesuar të kenë mundësinë dhe hapësirën e duhur se ku t’i orientojnë investimet e tyre. Gjatë këtij viti janë trajtuar 10000 kërkesa të ndryshme të qytetarëve nga kjo drejtori, vlen të ceket se kjo drejtori me qëllim të interesit të përgjithshëm ka filluar punën dhe aktivitetet e saj qoftë për funksionalizimin e Zonës Industriale që disa prona të kthehen në pronësi të Komunës me qëllim të realizimit të projektit të Zonës Industriale, po ashtu kemi filluar procesin e shpronësimit të disa pronave të cilat do të jenë në dispozicion të Komunës me qëllim të realizimit të projekteve Komunale, procese të cilat i kanë kaluar të gjitha fazat e AKP-së, dhe tani këto projekte kanë kaluar në procedurat e Ministrisë së Infrastrukturës ku do të bëhet vlerësimi i atyre pronave ku Komuna do t’i merr përsipër obligimet e saj, që të fillojmë me procesin e zhvillimit të këtyre aktiviteteve.

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ka realizuar një numër të madh të aktiviteteve sa i përket fushës së saj siç është funksionalizimi i bibliotekës së qytetit, orari në sallën e leximit është zgjatë nga ora 8;00 deri në orën 23;00, është bërë realizimi i javës së diasporës si dhe organizimi i panairit të prodhuesve vendor, rregullimi i ndriçimit dhe ngrohjes në bibliotekë, pasurimi me tituj të rinj librash për nevojat e bibliotekës, zhvendosja e arkivit në objektin e Komunës së vjetër, vendosja e këndit arkivor nga arkivi i përgjithshëm i Tiranës në arkivin e Komunës, ku studiuesit e ndryshëm nuk kanë nevojë që për një dokumentacion të ndryshëm të shkojnë në Tiranë sepse tani është këndi në Podujevë ku mund të qasen në dokumentacione të ndryshme. Është formuar këshilli i teatrit “Avdush Hasani”, dhe përzgjedhja e drejtorit të teatrit, gjithashtu kemi bërë mbështetje financiare në vlerë 90,000.00€ për shfaqje teatrore, klube sportive, kulturë dhe rini. Është bërë renovimi i palestrës së sporteve “Hakif Zejnullahu”, e cila nuk i ka plotësuar kushtet për zhvillimin e aktiviteteve sportive, po ashtu

është bërë renovimi i tërësishëm i bibliotekës së qytetit dhe renovimi i teatrit të qytetit “Avdush Hasani”, si dhe janë realizuar shumë aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, janë ndërtuar më shumë se 20 km kanalizim në qytet dhe fshatra, është bërë ndërtimi i ndriçimit publik mbi 100 km rrugë, janë ndërtuar 9 ura dhe kalesa kurse dhe 2 të tjera janë në procedurë, është bërë ndërtimi i më shumë se 8 km të trotuareve në lokalitete të ndryshme, ka vazhduar ndërtimi i kolektorit të ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza, është bërë ndërtimi i infrastrukturës në lagjet e Komuniteteve RAE në bashkëpunim me MAPL-në, ka vazhduar rregullimi i shtratit të lumit me gabiona në gjatësi prej 2 km, gjithashtu është bërë rregullimi i rrugëve me zhavorr në gjatësi 40 km si dhe mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe hapësirave tjera publike, mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, largimi i deponive ilegale në 45 lokalitete të ndryshme. Kemi trajtuar qenët endacak edhe pse gjendja nuk është e kënaqshme, kemi bërë mirëmbajtjen e parkingjeve dhe varrezave, është bërë shenjzimi i rrugëve si dhe riparimi i rrugëve të dëmtuara. Intervenime të zjarrfikësve gjatë këtij viti kanë qenë në 597 raste.

Drejtoria e Inspeksionit, ka bërë ndalimin e ndërtimeve pa leje, gjobitjen e subjekteve të cilat nuk i kanë respektuar masat e ndërmarra për luftimin e pandemisë Covid-19, janë bërë inspektime në subjektet afariste kundër shërbimit me pije alkoolike dhe duhan të personave nën moshën 18 vjeç, është bërë identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe shqiptimi i gjobave, parandalimi i prerjes së pyjeve, lirimi i hapësirave publike si dhe janë bërë inspektime të vazhdueshme për secilën fushë në kuadër të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë këtij viti ka mbështet me mullinj 50 fermerë në vlerë të projektit rreth 50,000.00€, mbështetja me mëshqerra, farë misri dhe koncentrat për 46 blegtorë, në vlerë 130,500.00€, pastaj mbështetja me mëshqerra për 70 fermerë, në vlerë 112,000.00€, mbështetja me fidanë të mjedrave për 50 fermerë, në vlerë 51,520.00€, mbështetja me shoqëri bletësh dhe koshere për 105 fermerë. Projekti i drunjëve dekorativ, mbjellja e mbi 2000 drunjëve dekorativ për rreth qytetit, parqeve, hapësirave shkollore, varrezave. Fermerët që kanë pësuar dëme nga fatkeqësitë natyrore janë kompensuar me 22.61% të dëmit të përgjithshëm kurse pjesa tjetër e dëmit është kompensuar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –MBPZHR. Në marrëveshje bashkëfinancimi me organizatën “Qatar Charity”, janë përkrahur 15 fermer me serra 120 m² dhe gjashtë (6) fermerë me nga tetë (8) shoqëri bletësh dhe pajisje pune, tani jemi në fazën e shpërndarjes për fermerë sipas kategorive, përkrahja me tufë dele me nga 10 krerë për 7 fermerë përfitues, 7 kosa për 7 fermerë përfitues, 11 freza, 6 lopë qumështore, 6 kultivatorë me frezë dhe kosë, 7 kultivatorë me frezë kosë dhe rimorkio për 7 fermerë përfitues. Në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovës (AKP) janë pyllëzuar në sipërfaqe prej 15 ha në fshatin Murgull dhe 10 ha në fshatin Revuç. Në marrëveshje bashkëfinancimi me organizatën “OZHR MËSHQERRA”, do të ketë mbështetje edhe për 45 fermerë me Mëshqerra Hollshtajn, përveç kësaj do të përkrahim me farë misri, koncentrat dhe do t'i mbulohen shpenzimet e veterinarit për mbarështim.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në kuadër të kësaj drejtorie është realizuar bashkëfinancimi me organizatën “Help” për financim me pajisje për punë për 20 gra ndërmarrëse në vlerë rreth 50,000.00€, grante për gratë në bujqësi në bashkëfinancim me Agjensinë e Zhvillimit rural- AZHR, në vlerë 16,500.00€, grante për trajtime për të rinjtë në ndërmarrësi në bashkëfinancim me AZHR-në në vlerë 6,000.00€, heqja e tarifës së bizneseve dhe falja e borxheve për bizneset me borxhe të mëdha, ngritja e produktit turistik, shtëpizat e drurit për festivalin dimëror, nisja e procedurave për shpronësim e tokës për ndërtimin e zonës industriale dhe takimet me mërgatën dhe ndarja e mirënjohjeve për investitorët nga mërgata. Këto janë disa nga punët dhe projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2021, sigurisht që kanë mbete disa projekte në fazën finale të realizimit të tyre dhe shpresojmë se do ta mbyllim këtë vit fiskal me një suficit buxhetor relativisht të ulët për dallim prej suficiteve

buxhetore të viteve të kaluara. Pavarësisht faktit që ju e dini se në këtë buxhet e kemi trashëguar dhe nuk është buxhet i planifikuar nga ana jonë por kemi qenë të detyruar që të mbështetemi në këtë buxhet që t'i realizojmë projektet e parapara nga ish qeverisja e kaluar dhe në këtë drejtim ne jemi duke ecur suksesshëm në përmbylljen e këtij viti buxhetor në shumën shumë të vogël të mjeteve buxhetore të cilat teprojnë. Disa projekte të pa realizuara ose që nuk janë realizuar që bëjnë pjesë në kategorinë e të hyrave vetanake të cilat nuk mund të kthehen mbrapa si suficit për arsye se ato mjete rikthehen prapë në vitin vijues dhe kemi mundësinë menjëherë pas fillimit të vit kalendarik të shfrytëzojmë. Brengë për këtë periudhë kohore është fakti që tani për shkak të njohura politike Komuna e Podujevës nuk ka arritur ta miratojë buxhetin për vitin 2022, dhe kam frikë se mund të kemi telashe në të ardhmen. Ne si ekzekutiv kemi hartuar një projektbuxhet shumë të mirë dhe gjithëpërfshirës por që nga periudha kohore e zgjedhjeve ne në Kuvend kemi pasur numër të vogël të anëtarëve në asamblenë komunale dhe pa votat e anëtarëve tjerë të asamblesë komunale ne nuk kemi mundur ta miratojmë buxhetin. Fatkeqësisht opozita e shfrytëzoi këtë mundësi për ta bllokuar buxhetin e qytetarëve e që besoj se do ta ndjejnë pjesën e përgjegjësisë për mos miratimin e buxhetit, si do që të jetë ne si ekzekutiv kemi qenë të hapur që t'i dëgjojmë kërkesat dhe nevojat e tyre apo vërejtjet dhe sugjerimet por fatkeqësisht ne nuk kemi pasur vërejtje dhe sugjerime sepse e gjithë kjo ka qenë politike në prag të zgjedhjeve lokale dhe nga ana e subjektve politike është treguar forca politike e tyre që kishin në asamblenë Komunale dhe arritën që ta bllokojnë këtë proces. Ne mendojmë se buxheti ka qenë për qytetarët dhe jo për partitë politike si do që të jetë ne punojmë dhe vazhdojmë të punojmë që në radhë të parë të bëjmë konstituimin e përgjithshëm të asamblesë komunale, ta zgjedhim Kryesuesin e Kuvendit, lidhur me këtë të premtën ne kemi pasur një mbledhje të jashtëzakonshme me qëllim të vetëm që të zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit dhe sigurisht e kemi parë dhe kemi dëgjuar se ne kemi pasur gatishmërinë ta zgjedhim Kryesuesin e kuvendin për faktin se nuk e kemi numrin e mjaftuar në asamblenë komunale dhe ta shtyjmë përpara këtë proces por partitë opozitare lëshuan sallën e Kuvendit dhe pamundësuan zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit dhe konstituimin e asamblesë Komunale. Ne si ekzekutiv prapë jemi në dispozicion dhe kemi gatishmërinë që këtë proces ta shtyjmë përpara e që besoj se në mbledhjen e radhës do të arrijmë ta përmbyllim këtë proces në mënyrë që mos të rrezikojmë që asambleja komunale të shkojë në zgjedhje të reja për arsye të kostos buxhetore dhe ne si subjekt politik por edhe si ekzekutiv nuk e kemi këtë vullnet. Opozita nëse mendon se asambleja duhet të shkojë në zgjedhje atëherë ne i kemi vetëm 13 numra prej 18 numrave të nevojshëm prandaj këtë proces ne nuk mund ta parandalojmë por sido që të jetë ne jemi në dispozicion që ta kalojmë këtë ngërç politikë, por nuk jemi ne që mund ta shtyjmë procesin përpara pa ndihmën e subjekteve opozitare në asamblenë komunale. Tani do ta hapim diskutimin me ju qytetarë të respektuar, mirëpo mundësisht së pari të prezantoheni për shkak të procesverbalit i cili do të publikohet dhe nga ana juaj kërkoj që kërkesat e juaja të jenë të fokusuar në projektet të cilat kanë qenë të planifikuara për tu realizuar dhe jo në projektet të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për arsye se kërkesat na marrin shumë kohë dhe në qoftë se kërkesat e tilla nuk kanë qenë të planifikuara në projekt buxhetin e këtij viti nuk është faji ynë por është faji i atyre të cilët e kanë përgatit këtë projektbuxhet dhe projektet e parapara që të realizohen gjatë këtij viti.

Sinqerisht ju them përveç se janë realizuar ato projekte të cilat kanë qenë të planifikuara si rezultat i menaxhimit të mirë të parasë publike për këto projekte ne kemi arritur të kursejmë rreth 500,000.00€ dhe me këto mjete kemi realizuar edhe disa projekte shtesë të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për këtë vit fiskal. Ne jemi në dispozicionin tuaj, këtu prezent me ne është drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe do t'i përgjigjemi ç'do pyetje apo interesimi që mund ta keni për fusha ose sektor të caktuar. Tani fjalën e keni ju, urdhëroni.

z.Ali Ibishi nga fshati Shakovicë, paraqiti kërkesat, dhe atë;

-Caktimi i parcelave të reja për varreza në disa fshatra të Komunës së Podujevës

-Mirëmbajtja e varrezave në fshatin Shakovicë ku si pasojë e vërshimeve janë dëmtuar andaj

të hapet një kanal i ujërave atmosferike.

-Shtatoret e varrezave të ngriten në bazë të kriterëve të cilat duhet t'i paraqesin ekspertët e kësaj fushe.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket mirëmbajtjes së varrezave qyteti i Podujevës ka nevojë për hapësira të reja të varrezave. Po sa kam marrë mandatin e Kryetarit të Komunës kam gjetur tri vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me një parcelë për varreza në fshatin Obrançë, një herë ajo parcelë është ndarë e tëra për varrezat e qytetit, kurse më vonë po ajo parcelë është përgjysmuar për varrezat e fshatit Obrançë dhe në fund e gjithë ajo parcelë është paraparë vetëm për varrezat e fshatit Obrançë duke përjashtuar nga ajo ngastër varrezat e qytetit. Ne gjatë bisedave që kemi pas me përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë-KBI, duke ndjerë nevojën e jashtëzakonshme për zgjerimin e hapësirave të reja për varrezat, për arsye se varrezat e qytetit të "Tjegullorja", "Hekurudha" dhe "Xhamia e Vjetër" janë stërmbushur ne kemi filluar një proces të shpronësimit të një parcele afër 10 ha në fshatin Obrançë për varrezat e qytetit të Podujevës, ky proces është vazhdim i atyre kërkesave që kanë qenë si për Zonën Industriale dhe disa parcelave tjera që kanë qenë në pronësi të Komunës. Sa i përket varrezave është një sipërfaqe që kemi paraparë për varreza dhe kemi filluar procedurat tani që një parcelë e ish kooperativës të jetë e destinuar për varreza. Ne e dimë që fshati Obrançë ka nevojë për hapjen e varrezave të reja por e tërë ajo sipërfaqe e cila është ndarë për varreza mendojmë se është sipërfaqe e madhe për fshatin Obrançë, ndoshta atë sipërfaqen më të vogël është dashur ndarë për varrezat e fshatit Obrançë kurse pjesa më e madhe e sipërfaqes për varrezat e qytetit, por si shumë vendime të mbrapshta që janë marrë edhe këto vendime janë marrë në atë mënyrë, kështu që ne jemi duke punuar në këtë aspekt dhe besoj se do ta zgjedhim këtë problem. Sa i përket varrezave të fshatit Shakovicë ne e dimë gjendjen e tyre dhe shumë shpejt ne do të fillojmë me projektin për largimin e ujit atmosferik që vjen prej fshatit Bellopojë, aty ka qenë kanali i ujërave mirëpo ai kanal është mbyllë nga persona të pa ndërgjegjshëm dhe si pasojë rrjedha e ujit ka hyrë në varreza. Këtë problem përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit do ta zgjedhim këtë problem qoftë me futjen e gypave apo me anë të një kanali të hapur sepse çdo ngritje e rritjes së ujit në nivelin e lumit Batllava ajo pjesë rrezikohet nga vërshimet si pasojë e mbylljes së kanalit edhe pse ne kemi bërë disa intervenime dhe do të kujdesemi për këtë çështje. Sa i përket ngritjes së lapidareve për caktimin e kriterëve mendoj se kjo punë është në kuadër të Bashkësisë Islame. Këtë iniciativë duhet ta marrë Bashkësia Islame dhe të caktojë një kriter për ngritjen e lapidareve. Komuna nëse fillon të involvoet drejtpërsëdrejti në këtë besoj se kjo çështje do të bëhet më problematike, andaj është mirë që KBI – Podujevë, të merret me këtë çështje ku ne jemi në dispozicion që t'ju ndihmojmë në këtë aspekt, përndryshe e kemi parasysh si fakt sepse ngritjen lapidare të mëdha që zënë shumë hapësirë në varreza andaj këtë iniciativë duhet ta merre KBI- Podujevë.

z. Shaip Hoxha nga fshati Penuhë, paraqiti kërkesat, dhe atë;

-Rregullimin e rrugës me zhavorr në lagjen Hoxha.

-Rregullimin e shtratit të lumit Llap afër varrezave të fshatit Llugë për shkak të vërshimeve në varrezat e fshatit Llugë si dhe në shtëpitë e lagjes Hoxha në fshatin Penuhë, vërshime këto që janë si rezultat i punimeve në shtratin e lumit Llap. Theksoi, nga ana juaj kërkojmë që të bëhet rregullimi i shtratit të lumit Llap dhe të sanohen vërshimet ose përndryshe ne duhet të shpërngulemi nga ai vend.

-Rregullimin e rrugëve në fshatin Penuhë që janë demoluar nga punimet e kolektorit të ujërave të zeza si dhe rregullimin e pusëve të rrjetit të kanalizimit dhe nga punimet e bëra rruga nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme qoftë nga ana e kompanisë së kontraktuar apo nga ana e komunës.

z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, ajo rrugë për të cilën e paraqitët kërkesën do të rregullohet infrastruktura e saj, sa i përket vërshimeve nga Lumi Llap, në shtratin e tij janë duke u zhvilluar punime që disa vite andaj arsyet pse kanë ndodhë vërshimet unë nuk i di

sepse nuk jam ekspert i asaj fushe, por Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit do të merret me këtë problem. Të gjithë ne e dimë gjendjen e Lumit Llap dhe këtë gjendje ne e kemi krijuar vet si qytetarë, duke e ngushtuar shtratin e Lumit në forma dhe mënyra të ndryshme, disa prej tyre kanë qenë të nevojshme për mbrojtjen e tokës bujqësore. Jemi duke punuar në projektin e zgjerimit të shtratis të Lumit Llap projekt që ka filluar te grykëderdhja dhe bashkimi i Lumit Llap me Lumin Batllava, projekt ky që është duke vazhduar. Lumenjtë zakonisht vërshimet i bëjnë në pjesët e poshtme dhe jo në pjesët e sipërme, këtu sikurse shumë punë që janë bërë mbrapsht edhe në këtë rast në vend se punimet të fillonin në pjesën e poshtme ato kanë filluar nga lart, andaj ne për ta rregulluar këtë problem punimet i kemi filluar nga ana e poshtme e Lumit Llap. Tani është viti i parë i punimeve në rregullimin e shtratis të Lumit Llap me gabion, punime këto që kanë arritur të realizohen deri te ura e hekurit në fshatin Lluzhan e që ky projekt do të vazhdojë tutje në drejtim të Qytetit të Podujevës vitin e ardhshëm. Vërshime mund të ketë por të keni para sysh se gjendjen të cilën e kemi trashëguar nuk ka qenë e lehtë që të menaxhohet, probleme të tilla kemi pasur edhe në qytet në lagjen e Tovërlanëve, ku brenda vitit 3-4 herë ajo lagje është vërshuar, këtë gjendje ne nuk e kemi krijuar ne por ata ekspertët e kaluar për 20 vite me radhë që kanë lejuar ndërtime pa leje dhe ndërtime mbi gypat që shpërndajnë ujin. Problemet 20 vjeçare nuk zgjidhen dot për 10 muaj dhe këto probleme i kemi evidentuar dhe kemi filluar t'i zgjedhim që nga lagjja e Tovërlanëve e që besoj se i njëjti problem edhe në fshatin Llugë së shpejti do të zgjidhet dhe ju nuk do t'i keni më këto probleme. Detyrë e jona është që të merremi me problemet dhe shqetësimet e juaja si dhe me këto dy raste. Sa i përket Kolektorit të ujërave të zeza dhe pusetave të cilat i potencuat, ju e dini se kush e ka ngritur zërin për atë kolektor dhe pikërisht kemi qenë ne. Janë 5,300,000.00€ kredi që i ka marrë komuna e Podujevës ku ndërtimi i 1 km të atij kolektori Komunës së Podujevës i kushton më tepër se 260,000.00€, kështu që ne kemi vendosur që këto punime më mos të vazhdojnë sepse është një buxhet marramendës dhe kemi 11km gyp të ndërtuara të këtij kolektori që na kanë kushtuar 5,300,000.00€. Ky projekt nuk ka pas mbikëqyrës dhe nuk është ditur projektuesi i tij dhe ne si Komunë jemi jashtë rrjedhave të këtij projekti, e kanë caktuar një mbikëqyrës formal sa për të bërë bartjen e parave (mjeteve financiare) të cilat bëhen përmes formave dhe rrugëve tjera jashtë Komunës edhe ne kemi pasur ankesa dhe jemi këtu ku jemi. Nuk jemi të kënaqur me punimet e bëra dhe e gjitha se çfarë kemi mundur të bëjmë është se këto punime nuk do të vazhdojnë më ashtu siç kanë vazhduar mirëpo ata i morën 5,300,000.00€ dhe i kanë realizuar 11 km ku kanë mbetur 11 km gyp i varrosur i cili është jashtë funksionit ku qytetarë të pa ndërgjegjshëm po i fusin ujërat atmosferike dhe si rezultat i tyre këta gypa do të mbyllen dhe ne do të paguajmë për 19 vite atë kredi të cilën e ka marrë ish pushteti i kaluar. Kjo është gjendja dhe ne kemi vërejtjet tona dhe kemi zhvilluar takime me ta ku kemi paraqitur vërejtjet dhe brengat të cilat i kemi pasur për këtë projekt, ata na kanë ofruar mundësinë që të vazhdojmë tutje me këtë projekt edhe me 6,000,000.00€ si dhe me 15,000,000.00€ për impiantin e ujërave të zeza me kosto të tërësishme prej 22,000,000.00€ borxhe, mirëpo ne si Komunë nuk kemi pranuar që të futemi në këto borxhe. Ne duhet të gjejmë rrugë dhe mënyrë se si ta realizojmë këtë projekt sepse 11 km gyp nuk duhet të mbesin të varrosur sepse ato investime janë bërë me taksat e qytetarëve tanë. Punimet me atë kosto që janë realizuar deri më tani ne nuk kemi mundësi që t'i vazhdojmë punimet me atë kosto të lartë financiare. Lumenjtë janë në gjendje shumë të keqe sepse në ta janë bërë rrjedha të ujërave të zeza fatkeqësisht dhe ne duhet ta bëjmë një zgjidhje por kemi edhe probleme tjera siç është problemi në lagjen Stubulla që iu kanë shfaqur problemet me rrjetin e kanalizimit se çfarë kanë bërë e çka kanë punuar (ish ekzekutivi) nuk jemi në dijeni. Gjendja në infrastrukturën nëntokësore është një katrahurë edhe pse janë bërë investime të mëdha financiare por pasojat po shfaqet në praktikë. E di që keni shqetësime, e di që edhe ngutëni për realizimin e këtyre projekteve sepse nuk është mirë që brenda një sezoni 2 apo 3 here të vërshohen shtëpitë si dhe të shkaktohen dëmet në ekonomitë familjare si rezultat i tyre. Këtë

problem nuk mund ta sanojmë lehtë dhe shpejtë por duhet evidentuar problemet dhe t'i sanojmë këto probleme sepse nganjëherë më lehtë është të fillohet një punë prej fillimit se sa të fillojnë meremetimet në disa punë të mbrapshta por si do që të jetë kjo është gjendja aktuale dhe më vjen keq se është kjo gjendje dhe ne jemi duke punuar në bazë të mundësive tona që gradualisht ti sanojmë këto probleme. Besoj se çështja e asaj pjese dhe e atyre varrezave do të zgjidhet, ju të gjithë e dini se shtratin e Lumit Llap e ka devijuar faktori njeri dhe tani ne duhet ta rregullojmë. Si pasojë e vërshimeve në fshatin Llugë janë vërshuar sipërfaqe të tëra të tokës bujqësore dhe e tërë ajo sipërfaqe është shkatërruar e që tani duhet vendosen kornizat për rregullimin e shtrati i Lumit sepse deri më tani aty nuk është ndërmarrë asnjë veprim dhe ajo pjesë ka qenë e lënë në dorën e fatit dhe Lumi i ka bërë manovrimet e tij dhe ka shkatërruar shumë sipërfaqe bujqësore. Qytetarët po të ishin në nivelin e duhur dhe të më kishin pyetur mua është dashur të ushtrojnë padi ndaj atyre që e kanë bërë këtë punë sepse për ta rregulluar shtratin e Lumit mendoj se të gjithë jemi të interesuar por të hapet aq sa kemi mundësi dhe potencial shtrati i Lumit dhe jo të hapet shtrati i lumit këndej stacionit e pastaj të shkaktohen vërshime në tokat bujqësore sepse ato toka ndoshta për 100 apo 200 vite nuk kthehen në gjendjen e mëparshme.

z.Veton Hoxha, nga Podujeva; parashtroni pyetje dhe kërkesa;

-Hapësira prej 1.8 ha për varrezat e fshatit Obrancë, kjo hapësirë nuk mjafton për të gjithë.

-Në shërbimin Alo Komuna kam bërë një kërkesë për rregullimin e shkallëve që gjenden te rruga "Skenderbeu" konkretisht tek parku, tek ura, aty dhe kam pritur deri në muajin korrik kur më janë përgjigjur por praktikisht kjo kërkesë nuk është realizuar pastaj në Drejtorinë e Shërbimeve Publike më datë 15.07.2021 kam paraqitur kërkesën e njëjtë mirëpo e njëjta nuk është realizuar deri më tani.

-Rregullimin dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara nga kompania e ujësjellësit në infrastrukturën rrugore.

-Rregullimin e orarit të punës për ditën e diele për bizneset që operojnë në Komunën e Podujevës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; theksoi, lidhur me pyetjen rreth varrezave, e përmenda më herët që kanë qenë 3 vendime, vendimi i 3-të i atyre vendimeve është për sipërfaqen në fshatin Obrancë që i kam gjetur këtu dhe që kanë kaluar nëpër Kuvend, vendimi i parë është i pa ligjshëm sepse i ka hyrë tokës së kooperativës pa e pyetur askënd, i ka vendos në lajthitje edhe asamblistët dhe ata e kanë votuar, pra është marr vendim për tokë të huaj sikurse të themi vendosi varresat në tokë private, vendimi i dytë është për qytetin e Podujevës, ndërsa vendimi i fundit është për fshatin Obrancë. Sa i përket shkallëve tek parku, te ura, duhet të rregullohen dhe besoj se do duhet të hyjë në projekt, nuk ka qenë si projekt i planifikuar për këtë vit por duhet të futet në projekt për vitin e ardhshëm dhe unë besoj se e zgjedhim këtë problem. Ndërsa dëmet që i shkakton kompania e ujësjellësit, është shumë e vërtet që kemi shumë telashe me KEK-un por edhe me ujësjellësin sepse këta nënshkruajnë kontrata por nuk i përgjigjen në kohë optimale dhe shumë prej këtyre përgjegjësive janë evidente, njëri prej problemeve dihet është ai që në fillim të rrugës së fshatit Obrancë që tani e sa kohë ka mbetur dhe është dashur ta sanojmë, unë besoj që me këto probleme do të merremi më seriozisht, me këto kompani dhe duhet të gjejmë formën se si me i sanksionua, por gjithsesi duhet pasur parasysh se janë në pyetje edhe nevojat e qytetarëve. Mbetet edhe prej Inspektionit por edhe prej Drejtorisë përkatëse të gjejnë rrugë për ta mbikëqyrur më mirë këtë proces. Sa i përket orarit të punës ju e dini që çështja e këtij orari është bërë pak problematik, si komunë sigurisht që kemi për obligim edhe bizneset ta respektojnë këtë obligim të tyre por kemi obligim të i respektojmë edhe kërkesat e punëtorëve, të atyre të punësuarve por ne si komunë nuk mundemi drejtpërdrejt me mbikëqyrë çështjen e të punësuarve për arsye sepse ata kanë një kontratë pune dhe ne si komunë nuk kemi inspeksion të punës, inspeksioni i punës i takon nivelit qendror. Inspektorati i punës e ka për obligim t'i trajtoj ato kontrata, që i referohen të drejtave dhe obligimeve nga marrëdhënia e punës se të punësuarve, ndërsa

Komuna nuk e ka këtë detyrë dhe tani në vazhdim të kësaj në lidhje me këtë pjesë të të punësuarve në këto biznese po duhet të mbesim peng i një vendimi të i detyrojmë bizneset të pushojnë të dielave. Ishte dashur që bizneset të jenë të lira në këtë aspekt, atij që i punohet të dielën le të punojë, kujt nuk i punohet nuk e ka për obligim të punoj por edhe paralizimi komplet i qytetit edhe i komunës nuk është në rregull sepse po sjell kokë qarjen e disa furnizimeve. Porsa të funksionalizojmë Kuvendin duhet të merremi seriozisht me këtë çështje, ta gjejmë një rrugë zgjidhje, sepse ne nuk jemi të interesuar të ia cenojmë të drejtën punëtorëve që punojnë në biznese, atyre me ligj dhe me kontratë ju takon dita e pushimit dhe këtë ditë ata e shfrytëzojnë të dielën apo të hënën apo ditëve të tjera kjo është punë e tyre, por tani ne nuk mundemi të mbesim peng i këtyre kontratave ose i atyre të pa përgjegjshëm që nuk e analizojnë këtë kontratë. E tëra çka mundemi është të kërkojmë nga inspektorati i punës të jenë më aktiv dhe të shohin a po shkelen të drejtat e punëtorëve apo jo, dhe ne domosdoshmërisht duhet ti thërrasim edhe bizneset t'i ulim dhe të bisedojmë me to që të gjejmë një rrugë zgjidhje. Shikoni tek ne është bërë një qendër tregtare, kjo qendër tregtare më mirë është të funksionojë në Podujevë këtu sesa qytetarët të shkojnë në Prishtinë në Albi Mall ose në qendrat tjera. Është më mirë është t'i lëmë ato para këtu sepse aty janë 300 të punësuar dhe në çoftë se e mbyllim të dielën, njerëzit të dielën e kanë atë vikend që mund të shkojnë dhe nuk e kanë mundësinë ditëve të punës. Të shikojmë dhe ta sjellim një vendim i cili nuk ka për ta cenuar as fuqinë punëtore por nuk ka për ta cenuar as biznesin, të gjejmë një solucion të përshtatshëm për të dyja palët, unë besoj që këtë do ta bëjmë sa të krijohet institucioni i asamblesë dhe do të shtyjmë procesin përpara.

z.Ditar Hoti, nga Podujeva; biznesmen nga Restorant "Ora", paraqiti kërkesat:

-Në vitin 2022 do të fillojë ndërtimi i autostradës dhe rrethi i saj do të bie 200m para Restorant "Ora", kërkesa ime është që prej rrethit deri te pika kufitare të hapet një trase sikurse në Komunën e Hanit të Elezit në mënyrë që këto biznese mos të paralizohen.

- Ministria e Infrastrukturës na ka thënë që prej rrethit dhe deri tek dogana në bashkëpunim me Komunën e Podujevës do të vendosim lidhur me këtë çështje.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, zakonisht këto autostrada janë të mbyllura dhe ne e kemi parë se janë autostrada në masën më të madhe gjysma të mbyllura e gjysma të hapura. Ne nuk do t'i cenojmë interesat e bizneseve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës ka mundësi që atë pjesë prej rrethit të jetë traseja e hapur deri në pikën kufitare, ne sigurisht se do të punojmë për t'i mbrojtur interesat e bizneseve tona dhe besoj se do të kemi mirëkuptim.

z.Agron Hetemi nga Podujeva; paraqiti kërkesat:

-Të lirohet hapësira publike në qytet që është zënë nga autobusët e linjës Podujevë –Sfeçël – Shajkofc.

-Të lirohet hapësira e qytetit ku janë të vendosur taksitë Podujevë-Prishtinë.

-Të rregullohet infrastruktura rrugore nga ana e ujësjellësit të cilët pas punimeve të bëra nuk e kanë bërë kthimin e infrastrukturës rrugore në gjendjen e mëparshme.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, linja e autobusëve Podujevë –Sfeçël – Shajkofc, me të vërtetë janë duke krijuar tollovi në komunikacion dhe shumë shpejt posa ta kompletoj ekzekutivin do të merrem me këto dy çështje të cilat i parashtruat. Do ta ndajmë një lokacion të përshtatshëm për këto linja në mënyrë që mos të ketë bllokime në trafik. Sa i përket kompanisë së ujësjellësit e sqarova më herët.

z.Besmir Jaha, nga fshati Ballofc; paraqiti disa kërkesa dhe atë;

- Shtirirja e rrjetit të Kanalizimit jo vetëm për resortin turistik por edhe për lagjen Shamalluku dhe për disa lagje tjera të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur sepse nga ajo pjesë 40 familje furnizohen me ujë të pijshëm dhe si rezultat i mungesës së rrjetit të kanalizimit këto familje do të mbesin pa ujë të pijshëm si rezultat i kontaminimit të ujit.

- Të merren veprime konkrete për mbrojtjen e natyrës nga degradimi si dhe të merret në mbrojtje nga ana e institucioneve të komunës Kalaja e Ballofcit e quajtur "Kalaja Laberion",

ku nga qytetarë të pa ndërgjegjshëm dhe nga kompani të ndryshme janë bërë gërmime dhe si rezultat i saj aty është bërë një deponi e mbeturinave.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, aty ku mungon shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ne e kemi obligim që domosdoshmërisht ta shtyjme përpara këtë proces. Këtë vit kemi mjete buxhetore e që besoj se shumë shpejt në shumë fshatra do të fillojmë me investime por prioritet do të kenë ato fshatra ku janë disa punë të domosdoshme që duhet të kryhen sa më herët që është e mundur. Atje në saje të një projekti që kemi pasë kemi arrit të fillojmë me shtrirjen e një pjese të rrjetit të kanalizimit përafërsisht rreth 2 km dhe sipas nevojës ne do të vazhdojmë edhe sipas nevojës do të vazhdojmë me shtrirjen e rrjetit të kanalizimit. Kërkesat duhet të paraqiten në DSHPMSh dhe këto projekte me i shty përpara qoftë për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit apo ujësjellësit. Sa i përket degradimit të natyrës është me të vërtetë shqetësuese e sidomos për disa objekte të cilat nuk llogariten si monumente të trashëgimisë sonë siç është rasti me kalanë për të cilën nuk e di statusin e saj se a është në listën e mbrojtur të monumenteve trashëgimore- kulturore dhe nëse nuk është në këtë listë atëherë është mirë që të merrni iniciativë ju si lokalitet ta përcillni një kërkesë zyrtare te ne dhe ne pastaj do e përcjellim atë kërkesë në zyrën rajonale të trashëgimisë shtetërore në mënyrë që të rregullojmë statusin e saj e pastaj do të merremi seriozisht me këtë çështje jo përse ne dëshirojmë t'i ikim përgjegjësisë por së pari iniciativa duhet të fillojë nga ju. Deponitë ilegale janë problematike dhe ne për këtë kemi nda një shumë buxhetore mirëpo kjo dukuri ende po vazhdon, rast konkret kemi pjesën e fshatit Livadicë ku qytetarë të pa ndërgjegjshëm skaj rrugë hedhin mbeturina ku Komuna e ka pastruar atë zonë disa herë dhe ka vendosur njoftim për ndalim të hedhjes së mbeturinave si dhe janë shqiptuar gjopa për persona të pandërgjegjshëm. Ne duhet të veprojmë në këtë drejtim së bashku me gjithë ata qytetarë që jetojnë përreth asaj pjese sepse është problematike të ruhet ajo pjesë. Këtë problem ne duhet ta zgjedhim dhe është momenti që të gjitha ekonomitë familjare t'i fusim në proces të pagesës për mirëmbajtjen e mbeturinave andaj shuma mujore prej 4.7€ nuk është shumë që nuk mund t'i përballojnë ekonomitë familjare, në mënyrë që të parandalohen hedhjet e mbeturinave në vend e pa vend por mbeturinat do i vendosin para dyerve të shtëpive e që kompania do shkojë t'i marrë ato, kështu që zhvillohet kompania dhe rritet numri i të punësuarave në kompani dhe kemi mundësi që t'i rrisim kapacitetet infrastrukurore brenda kompanisë si dhe të zgjedhim problemin e këtyre deponive të egra. Zgjidhje tjetër nuk ka, unë mendoj se në fillim të vitit ne duhet të marrim një vendim ndoshta edhe në asamblenë komunale. Puna e parë që dëshiroj ta bëjë është që atë kompani ta kthej në menaxhim të Komunës dhe jo të jetë Kompani në nivel regional sepse ata kryejnë shërbime te ne kurse qendrën dhe përgjegjësitë i kanë në Prishtinë andaj do të mundohemi që këtë kompani ta shndërrojmë në kompani publike komunale që përgjegjësitë të na i japë neve dhe t'i merr përsipër të gjithë punëtorët, e pastaj të fillojë me zgjerimin e kapaciteteve. Zgjerimin e kapaciteteve nuk mund ta bëjmë në qoftë se nuk i fusim në sistemin e pagesave të gjitha ekonomitë familjare, a do të ketë refuzime sigurisht që po por zgjidhje tjetër për mënjanimin e këtyre deponive ilegale të egra nuk kemi. Po marrë shembull, ka raste kur qytetarët nisen nga fshati Obrançë me traktor me mbeturina shkojnë në fshatin Murgullë ose Zhiti dhe atje i hedhin mbeturinat pastaj prej në dru dhe kthehen prapë në shtëpitë e tyre. Së paku deri më tani pjesët e sipërme të qytetit që kanë pas banorë më pak kanë qenë të ruajtura kurse tani edhe ato pjesë kanë filluar të degradohen, ne këtë problem duhet ta zgjedhim diqysh dhe rrugë tjetër për zgjidhjen e këtij problemi unë nuk shohë sepse këta persona ose këto ekonomi familjare nëse i fusim në sistemin e pagesave nuk kanë nevojë që mbeturinat e tyre ti ngarkojnë në traktorë dhe t'i hedhin në fshatin Murgullë apo në fshatin Zhiti sepse kompania shkon në shtëpitë e tyre dhe i merr ato, më falni që si shembull e mora fshatin Obrançë se mund të jenë edhe qytetarë të fshatit Shajkofc ku marrin mbeturina i hedhin në fshatin Herticë. Këta ishin vetëm shembuj.

z.Fadil Berisha përfaqësues i fshatit Kunushëfc; paraqiti kërkesat;

- Furnizim me ujë të pijes për gjithë fshatin Kunushëfc
- Ambulanten e fshatit për fshatrat Kunushëfc, Buricë dhe Penuhë
- Asfaltimin e 6 rrugicave si dhe rregullimin e tensionit të lartë të energjisë elektrike për fshatrat Kunushëfc, Gllamnik dhe Llapashticë e Poshtme.
- Hapjen e rrjetit të kanalizimit si dhe trajtimin e qeneve endacak.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, çështja e ambulantes besoj se mund të zgjidhet, nuk po ju premtoj publikisht mirëpo do të punojmë që brenda vitit 2022 do të zgjidhet ky problem sepse janë disa donacione dhe besoj se përmes tyre do ta gjejmë mundësinë për ndërtimin e ambulantes. Një gjë ta keni parasysh ne e kemi mbush Podujevën me ambulanca si objekte infrastruktorore por personel mjekësor nuk kemi dhe për ta rritur numrin e të punësuarave është goxha një sfidë, sepse kemi probleme me punësimin e stafit mjekësor. Ambulantat të cilat i kemi aktualisht kemi probleme me resurse humane, kemi ambulanten e fshatit Dobërdol ku largësia mes fshatit Dobërdol - Bajçinë dhe Kërpimëh është shumë e shkurtër, tani kemi ambulanten edhe në fshatin Dobërdol, ne mund të ndërtojmë objekte të cilat kanë qenë të planifikuara por pa të keqe këto fshatra janë shumë afër mes veti tani ne mund të ndërtojmë ambulanta por nuk kemi resurse sepse është problematikë rritja e numrit të personelit mjekësor pavarësisht dëshirës tonë këtë nuk na e lejon Ministria e Financave. Mirë do të ishte mirë që të bëhen kombinime të kërkesave të mundësive dhe nevojave. Kërkesa mund të ketë, por po ju tregoj se në ambulanten e fshatit Majac asnjë shërbim nuk ofrohet, në ambulanten e fshatit Lupç marrin shërbime mjekësore 10 pacientë kurse në QMF në fshatin Lluzhan marrin shërbime mjekësore 2000 pacientë, në fshatin Batllavë marrin shërbime mjekësore 15-20 pacient, në fshatin Halabak marrin shërbime mjekësore 7-8 pacientë në fshatin Dyz marrin shërbime mjekësore 2 pacientë. Ne mund të ndërtojmë objekte por qytetarët në këto objekte nuk marrin shërbime mjekësore andaj shtrohet pyetja pse qytetarët e fshatit Dyz nuk i marrin shërbimet mjekësore në ambulanten e fshatit të tyre kurse shërbimet i marrin në QMF në fshatin Lluzhan. Arsyeja është se shërbimet mjekësore në ambulanten e fshatit Dyz ofrohen 1 herë apo 2 herë në javë në raste kur mungon mjeku shërbime nuk mund t'i ofrojë motra medicinale si dhe ka mungesë të barërave andaj këta qytetarë shërbimet e tyre mjekësore i marrin në fshatin Lluzhan, e njëjta gjë ndodh edhe në fshatin Gllamnik ku banorët e tij shërbimet mjekësore i marrin në fshatin Lluzhan. Problemi qëndron në mungesë të resurseve dhe nuk mund t'i mbulojmë të gjitha këto objekte, problemi nuk qëndron në ndërtimin e objekteve por te funksionimi dhe mirëmbajtja e tyre andaj problemi qëndron se nuk mund ta rrisim numrin e personelit mjekësor këtë problem e kemi edhe në administratën komunale sepse numri është i kufizuar si do që të jetë ne do t'i shikojmë mundësitë për investime në fshatin Kunushëfc. Sa i përket tensionit të lartë të energjisë elektrike, kjo është detyrë e KEDS-it. Sfidë kemi trajtimin e qeneve endacak, gjatë këtij viti kemi harxhuar mbi 30,000.00€, për trajtimin e qeneve endacak mirëpo ky problem nuk është zgjidhur sepse është problem që nuk mund të menaxhohet lehtë. Qytetarët janë të rrezikuar nga qenët endacak mirëpo ne duhet të gjejmë rrugë se si ta zgjedhim këtë problem. Gjatë javës në vijim unë kam një takim me organizatën për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve dhe do të shikojmë se si mund ta zgjedhim këtë problem.

z.Raif Osmani nga fshati Dumnicë e Epërme; paraqiti kërkesat;

- Asfaltimi i rrugës në lagjen Jaholli rrugë lidhëse mes fshatrave Dumnicë e Epërme – Llaushë në gjatësi 1200m lagje në të cilën janë 15 shtëpi me 75 banorë .
- Hapjen e kanaleve të rrugës lidhëse mes fshatrave Dumnicë e Epërme – Llaushë ku si pasojë e tyre shfaqen vështirësi në transportin e nxënësve për në shkollë si dhe largimin e mbeturinave nga kjo rrugë.
- Kërkesën për asfaltimin e kësaj rruge e kemi bërë në fillim të vitit mirëpo përgjigje nuk kemi pranuar ende.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; theksoi, kërkesa e juaj duhet të shqyrtohet ndoshta brenda këtij viti sepse aty është një rrugë me gjatësi 1200m dhe kemi 15 shtëpi në atë lagje,

ju duhet ta ripërtërinë kërkesën që kjo rrugë të futet në projekt buxhet sepse tani është faza e përfundimit të buxhetit për këtë vit por do t'i shikojmë mundësitë se çka do të bëjmë për vitin 2022. Sa i përket deponive ilegale të mbeturinave, e ceka më lartë, se është mirë që ne si qytetarë ta japim kontributin tonë në këtë aspekt. Nëse e shihni dikë se po hedh mbeturina ju lutem fotografojeni dhe atë fotografi të individit apo të makinës qoftë edhe targat e tyre përcillni te ne në Drejtorinë e Inspeksionit. Rast të ngjashëm kemi pasur në fshatin Dumosh ku një qytetar i pa ndërgjegjshëm me kamionetë ka hedh mbeturina mirëpo ka mjaftuar një foto e targave të kamionetes dhe atij individit i është shqiptuar dënimi. Ne duhet të bashkëpunojmë mes veti, përndryshe po qe se mungon ky bashkëpunim atëherë shumë punë nuk mund t'i përfundojmë. Institucioni i Komunës nuk mund të jetë polic në çdo vend sepse (një fjalë Popullore thotë se) kufirin dhe malin i ruan frika jo kufitari apo roja e pyllit, kufirin e ruajnë qytetarët që jetojnë aty edhe ju ejani të bashkëpunojmë më shumë, tani është sektori Alo Komuna ku thirrjet telefonike janë pa pagesë sepse në bazë të një fotografie të një qytetari të ndërgjegjshëm ne i shqiptuam gjobën dhe ai person e ka paguar gjobën dhe ka kërkuar falje, ju siguroj se ai person më nuk e përsërit një veprim të tillë, prandaj në këtë drejtim ju mund të na ndihmoni shumë. Bëhuni qytetarë aktiv lajmëroni këto raste në mënyrë që të kemi një ambiente më të mirë dhe më të pastër, mos hezitoni. Në qoftë se ata individ të pa ndërgjegjshëm ua ndotin jetën me mbeturinat e tyre dhe ua rrezikojnë jetën e fëmijëve atëherë pse ju duhet t'i mbronin ata, andaj lajmëroni institucionet që të mënjanohen këto veprime të dëmshme. Bashkëpunimi i ndërsjellët ndikon pozitivisht në këtë drejtim.

z.Besmir Jaha nga fshati Ballofc; theksoi, vetëm desha të lidhem me këtë pjesën e mbeturinave, a ka mundësi që komuna të vendos kamera në këto lokalitete në mënyrë që mos të ketë lajthitje dhe konfrontime nga ana e banorëve me personat e pa ndërgjegjshëm që hedhin mbeturina.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, po të kishte mundësi ne do t'i vendosnim kamerat, por është problem vendosja e tyre sepse duhet të kenë softuer lidhje të internetit.

z.Besmir Jaha nga fshati Ballofc; theksoi, i nderuar Kryetar te ne në fshatin Ballofc në lagjen Mehana mund të vendoset një kamerë sepse është vetëm një rrugë dhe përmes kësaj rruge ata persona të pandërgjegjshëm nuk kanë rrugë tjetër që të kalojnë. Kemi rast kur është lajmëruar policia mirëpo janë vonuar 1 orë deri sa kanë ardhë prej Podujevës në Ballofc.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, ne kamerat mund t'i vendosim por përpos energjisë elektrike problemi qëndron edhe në shtrirjen e rrjetit të internetit.

z.Gani Visoka nga fshati Kunushëfc; paraqiti kërkesat;

- Trajtimin e qeneve endacak që rrezikojnë jetën e nxënësve dhe qytetarëve në fshatin Kunushëfc dhe fshatrat përreth.

- Hapjen e pusëtës së rrjetit të kanalizimit në livadhet e fshatit Kunushëfc.

- Rregullimin e trasesë së tensionit të lartë të energjisë elektrike që e ceku më lartë z.Fadil Berisha.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, çështjen e qeneve endacak e diskutuam dhe besoj se të gjithë bashkërisht duhet ta zgjidhim këtë problem. Sa i përket trasesë së tensionit të lartë të energjisë elektrike prapë po u them se kjo është kompetencë e KEDS-it dhe për të gjitha dëmet që i shkaktojnë në pronat e juaja ata e kanë për obligim që t'i kompensojnë. Këtë problematikë është mirë me adresue në KEDS, besoj se ky problem duhet të zgjidhet andaj nga ana juaj të paraqitet ky rast në zyrat e KEDS-it dhe në DSHPMShP, në mënyrë që ne t'i paraqesim KEDS-it kërkesë që sa më shpejt të rregullohet kjo problematikë.

z.Fadil Bici nga fshati Godishnjak; paraqiti kërkesat;

-Asfaltimin e disa rrugicave në fshatin Godishnjak

- Asfaltimin e rrugës së lagjes Mehmeti në gjatësi 100m dhe si shkak i rrugës kompania e pastrimit nuk shkon në këtë lagje dhe këta banorë detyrohen t'i bartin mbeturinat e tyre deri në lokacionin ku vjen kompania e pastrimit.

-Asfaltimin e rrugës në lagjen Kastrati si dhe rrugën "Fahri Bici".

-Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit në fshatin Godishnjak.

z. Shpejtim, Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, janë disa kërkesa që duhet analizuar besoj se do tu bëjmë zgjidhje.

z. Bejtush Dushi, nga Podujeva; paraqiti kërkesat;

-Funksionalizimin e një linje qarkore për transportin e nxënësve vajtje ardhje në shkollë prej Qershiave të Llapashticës në rrugën "Skenderbeu" deri te rreth rrotullimi.

-Ndërtimin e një nënkalimi ose mbi kalimi në rrugën maxhistrale te Qershiat e Llapashticës sepse është duke u rrezikuar jeta e qytetarëve dhe fëmijëve tanë.

-Ndërtimi i rrugës "Skënderbeu" kur do të bëhet dhe në sa korsi.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; theksoi, rruga "Skënderbeu" do të meremetohet këtë vit, për këtë rrugë është ndarë një shumë rreth 700,000.00€, për projektin meremetimi i rrugës "Skënderbeu", në atë pjesë ku uji ec përmbi rrugë në vit 2022 do të hiqet si dhe ujërat atmosferike. Këtë vit për këtë arsye në atë rrugë nuk është investuar sepse ne kemi pas një buxhet të vogël që kemi mundur të investojmë për 2km të asaj rruge por nuk e kemi bërë për arsye se ato mjete investoheshin kot në vjeshtë kur është planifikuar që punimet të vazhdojnë në pranverë. Ajo pjesë e qytetit ka nevojë për ndërtimin e një shkolle të re që si problem kyç është mungesa e pronës publike për ndërtimin e shkollës së re. Së bashku me ju ne duhet të punojmë deri në gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për ndërtimin e një shkolle të re në atë pjesë, ajo zonë është në zhvillim e sipër kështu që ne detyrimisht ose duhet ta shpronësojmë ndonjë parcelë të përshtatshme për ndërtimin e shkollës në atë pjesë të qytetit dhe në këtë drejtim ju si komunitet duhet të na ndihmoni. Sa i përket udhëkryqit ju e dini se tash e ca vite aty janë folur për disa projekte të ndryshme mirëpo përfundimisht është marrë vendimi që aty të ndërtohet një rreth rrotullim, varësisht nevojave të qytetarëve aty do të ndërtohet një nënkalim por projektet e parashikuara më parë nuk do të realizohen, besoj se ky problem do të zgjidhet. Kompania që e ka fituar atë projekt për atë pjesë të lotit është tërhequr prej punimeve për atë arsye punimet kanë mbetur në gjysmë. Premtimet e qeverisë ju i dini prandaj besoj se gjatë vitit 2022 do të përmbyllen këto projekte. Çështja e nënkalimeve dhe mbi kalimeve është mbyllur, ju e dini se ka pasur veprime të ndryshme si ndërtime të objekteve të ndryshme dhe të gjitha gjërat që kanë ndodh por definitivisht në atë pjesë do të ndërtohet një rreth rrotullim.

z. Bejtush Dushi nga Podujeva; fillimisht ju falënderoj për shtrirjen e ndriçimit publik kah restoranti "Artela" duke përfshirë edhe pjesën e shtruar me trotuare edhe pse ende nuk ka përfunduar. Unë frekuentoj shpesh në atë rrugë, por në rrugën prej varrezave në drejtim të restorantit "Artela" e sheh turpin e Llapit për shkak të hedhjes së mbeturinave. Andaj e përkrah mendimin që çdo shtëpi duhet të futet në sistem për pagesën e bartjes së mbeturinave.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; jemi në pritje të funksionalizimit të Kuvendit të Komunës dhe si rrjedhojë për të formuar këshillat dhe kryetarët e fshatrave, e pastaj për të organizuar një kampanjë, për të marrë mendimet edhe të qytetarëve të tjerë në të gjithë rajonin e Komunës, për të marrë edhe një lloj pëlqimi edhe nga ana e tyre për përfshirjen e tyre në sistem të pagesave për bartjen e mbeturinave dhe besoj se ajo është e vetmja rrugë për zgjidhjen e këtij problemi.

z. Halim Sinani nga fshati Peran; theksoi, kam tri pyetje:

Disa gypa në fshatin Murgullë, as udhëheqja e përparme, as kjo e tanishmja nuk keni qenë në gjendje me i vendosë. Në zonën kufitare në rrugën Murgullë, Bellasicë tre km nuk është shtruar fare zhavorr. Pastaj nëpër rrugë e dyqane vërehet shitja e mjaltit, shtrohet pyetja, shitësit e tyre a kanë ndonjë certifikatë, sepse sa jam në dijeni në vendet që ne kufizohemi nuk guxon të bëhet shitja e mjaltit në rrugë pa certifikatë, në këtë gjendje nuk dihet se çfarë përmban dhe çfarë shitet. Dhe si çështje e fundit, vijnë qytetarë me automjete dhe rimorkio bëjnë prerjen e pyjeve, ndërsa pylltari arsyetohet se nuk është përgjegjës për ruajtjen e pronave/pyjeve private.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; z. Halim për çështjen e rrugës Murgull-Marincë-Bellasicë ajo është në planin buxhetor për vitin që po vjen. Ne e dimë që atje në atë zonë nuk ka më banorë dhe arsyet pse ka ngecur deri më tani nuk i di, por ndoshta në prioritet kanë qenë rajonet me vendbanime dhe nevojat që kanë pas qytetarët.

Janë disa biznese atje dhe interesimi ynë është që të rregullohet ajo rrugë dhe besoj se do ta kryejmë. E dyta, çështja e mjaltit që u theksua, nëse shkon në Shqipëri apo Maqedoninë e Veriut shitjen e mjaltit e has skaj rruge. Ekonomitë familjare kanë të drejtë shitjen e prodhimeve të tyre. Se sa është i kontrolluar ushqimi ne të gjithë e dimë. Sigurisht jeni në dijeni se kjo është në kompetencë të AUVK. Ne kemi Inspeksionin e tregut, i cili bënë inspektime dhe kontrole, por është problem sepse shumë ekonomi familjare (bletarë) nuk kanë certifikatë biznesi. Mirë do të ishte të veprohet ashtu sikurse theksoi parafolësi, por të gjithë e dimë se si ec dhe zhvillohet ky proces, por mbetet të ardhmen me punuar në këtë drejtim. Sa i përket çështjes së gypave dhe rrugës dua të theksoj se kemi pas shumë projekte tjera shumë më të rëndësishme. Tani më rruga ka hyrë në planifikim dhe do të rregullohet, sepse të tjerët (qeverisja e kaluar) që 20 vite nuk janë marrë me atë punë. Sa i përket pronave private, ne kemi problemin me prerjen ilegale të pyjeve dhe kjo është shumë brengosëse si për ne ashtu edhe për qytetarët. Për pronat private është mirë të kujdesen vet edhe pronarët e tyre, por gjithashtu mendoj se duhet punuar më shumë edhe njësia e pylltarëve, Agjencia Pyjore e Kosovës, por edhe Policia e Kosovës, pra duhet të jenë në nivel pak më të lartë të përgjegjësisë me qëllim të ndaljes së kësaj dukurie. Përndryshe jemi në gjendje shumë të rëndë sa i përket prerjes dhe dëmtimit të pyjeve dhe kjo është brengë e përgjithshme sepse shumë pak jemi duke pyllëzuar sipërfaqet, ndërsa dëmet nga prerjet janë shumë më të mëdha. Pra duhet të angazhohemi të gjithë dhe në bashkëpunim me ju mund të ndikojmë në zvogëlimin e saj në masë më të madhe, prandaj urdhëroni, na lajmëroni për këto probleme, sepse jemi në dispozicionin e juaj dhe do të veprojmë në kuadër të autorizimeve ligjore.

Liridon Kosumi nga fshati Halabak; i kam disa kërkesa të cilat i kemi paraqitur edhe gjatë mandatit të mëhershëm:

-Për kyçje në kanalizim të lagjes Salihu, sepse ata banorë ende nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit, por derdhja e ujërave të zeza bëhet në lum.

Për hapjen, pastrimin e shtratit të lumit si dhe ngritjen e një bankine përgjatë lagjes Kosumi dhe Salihu, është hera e pestë apo e gjashtë, ku dalja e ujit nga shtrati i lumit na ka hyrë dhe dëmtuar edhe nëpër shtëpi. Këtë çështje e kemi përcjellë edhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinorë. Në vitin 2017 Komuna e ka pas një projekt për zgjerim të lumit por nuk ka arritur të hapet sa duhet lumi dhe nuk janë ngritur bankinat sa është dashur të ngritën.

-Për asfaltimin e rrugës 2.5 km që i lidh disa lagje të fshatit, ku si shkak i rrugës ka edhe familje që janë larguar dhe ka familje që presin të largohen. Për këtë rrugë kemi bërë kërkesa të mëhershme.

-Asfaltimi i një rruge në lagjen Krasniqi, në gjatësi prej 350-400 m, ku projekti i nuk ka shkuar deri në fund, me ç'rast dy familje kanë bërë kërkesa disa herë.

-Për inspektimin e dëmeve të rrugës kryesore të fshatit. Sikurse jeni në dijeni z. Kryetar rruga është shtruar në vitin 2004 me participim të qytetarëve. Rruga është dëmtuar prej kamionëve të cilët bartin materialin e gurëthyesit nëpër tërë territorin e Komunës së Podujevës, pra dëmtohet ajo rrugë dhe askush nuk po jep përgjegjësi për këtë. I kemi bërë kërkesë Ministrisë së Transportit në vitin 2019 ku e kemi përsëritur, por edhe Komunës, që të ndërmerret diçka, përndryshe, ne si banorë nuk kemi mundësi financiare për ta rregulluar prapë atë rrugë.

-Pse nuk ka vazhduar projekti i ndriçimit për në fshatin Tërnavë-Bellopojë, desha të dijë se çfarë ka ndodhë me atë projekt pse nuk u zbatua dhe kur do të vazhdojë.

-Sa i përket varrezave të fshatit Shakovicë është shumë lehtë për të bërë zgjidhje, duhet një bankinë shumë më e lartë se sa ajo që është, hapja e atij kanali që e kanë mbyllur qytetarët.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; më herët kur dhashë përgjigje për lumin Llap për çështjen e këtyre bankinave, atje ajo rrjedhë ujore është me probleme dhe duhet të hapet

sikurse edhe në pjesët tjera, besoj se në vitin që po hyjmë do të bëjmë diçka në atë drejtim. Te lagja Kuleta do të dalim dhe të shohim praktikisht cila është nevoja në atë pjesë, sepse unë kam pas të investojë atje dhe më është thënë se nuk është e nevojshme se gjendja nuk është keq. Por gjithsesi do të investojmë te ajo lagje. Te lagja e Krasniqëve ju thatë se nuk kemi investuar, unë sa jam në dijeni ose kemi pasur për qëllim me investuar por do të interesohem për këtë çështje dhe besoj se këtë vit do të merremi me atë lagje. Çështja e dëmtimit të rrugës, realisht ashtu edhe është, sepse kam informacionet, por nuk është dëmtuar vetëm nga gurëthyesit por edhe nga makineritë tjera, megjithatë rruga është publike dhe shfrytëzohet dhe ne nuk mund t'i ndalojmë, ndoshta do të ishte mirë që të përkufizohet pesha e lejuar e qarkullimit në atë rrugë. Sa i përket mirëmbajtjes, duhet interesuar, nëse është kompetencë e jona ne duhet ta mirëmbajmë, e nëse nuk është në kompetencë të Komunës atëherë duhet kërkuar prej Ministrisë për ta mirëmbajtur dhe besoj se kjo çështje do të zgjidhet. Sa i përket ndriçimit, projekti ka qenë deri në atë pikë ku dhe ka përfunduar projekti. Ne kemi hapur një tender të dytë dhe fatkeqësisht i njëjti na është bllokuar me ankesa në kuadër të OSHP-së.

z. Mehmet Fazliu, nga Podujeva; parashtrroi pyetje dhe kërkesa.

-Çka është duke bërë kjo shoqëri dhe ky Kuvend Komunal për çështjen e personave me aftësi të kufizuar, sepse edhe ata njerëz janë pjesë e shoqërisë sonë si në çdo shtet që ka persona me aftësi të kufizuar.

- Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në rrugën "Ibrahim Rugova", për 10 shtëpi, ku kërkesën e kemi nënshkruar 100 persona.

- Objekti i burgut të vjetër paraqet rrezik për jetën dhe sigurinë e nxënësve, dëshmitarë jam se në atë vend një person me aftësi të kufizuar e kanë sulmuar qentë endacak.

-Ambulanta e ndërtuar në atë pjesë vetëm figuron si e tillë sepse nuk është funksionale dhe nuk ka sinjalizime për lokacionin e saj andaj më mirë do të ishte që ajo ambulante të ishte ndërtuar diku më afër rrugës se sa në atë pjesë ku është tani.

-Mirëmbajtjen e varrezave të qytetit te Tjegullorja.

-Mirëmbajtjen e parkut të qytetit afër urës së lumit Llap- pjesën ku qarkullojnë vetura të ndryshme.

z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës theksoi; ne kemi organizatën "Handikos", për trajtimin e kësaj kategorie ku si institucion Komunal kemi ndarë një shumë prej 12,000.00€. Normalisht për pjesët dhe gjërat tjera merremi ne si institucion pavarësisht kësaj, nëse janë raste që kanë nevojë për ndihmë dhe gjëra të tjera ne i trajtojmë, ata persona që kanë nevojë për barëra ne ju ndihmojmë. Më herët paraqita shumat bukur të mëdha që janë investuar për t'ju ndihmuar kategorive që kanë nevojë cila do qoftë ajo kategori, kështu që jemi duke u munduar që këtyre personave t'ua bëjmë jetën më të lehtë në bazë të këtyre mundësive që ne i kemi. Sa i përket ujit të pijes për këtë problem jam interesuar dhe ky problem është i më hershëm e që ka kohë që ne ballafaqohemi me këtë problem. Këtë vit do ta zgjidhim këtë problem sepse duhet të hapet rruga mirëpo sipas informacioneve problemi qëndron te rruga sepse përbrenda infrastrukturës rrugore ka pasur prishje edhe kyçje të ndryshme në rrjetin e ujësjellësit dhe këtë problem do ta zgjedhim kur të fillojnë punimet në rrugë për ato shtëpi të cilat ju i cekët. Sa i përket burgut të vjetër, njerëzit që kanë jetuar aty kanë marrë iniciativë që të bëhen disa ndryshime pastaj Drejtoria e Kulturës ka ndërmarrë veprime për atë objekt sepse ai objekt është i vjetër dhe ka rëndësinë e tij, tani institucioni regjional i mbrojtjes së monumenteve këtë objekt e ka marrë në mbikëqyrje dhe tani nuk është në mbikëqyrjen dhe kompetencën tonë si institucion lokal. Ky objekt është futur në listën e objekteve në mbrojtje të përkohshme dhe punimet janë ndaluar sepse në atë objekt nuk mund të bëhen ndryshime, sipas të gjitha gjasave institucioni regjional i mbrojtjes së monumenteve do të merret me këtë çështje. Sa i përket Ambulantes ajo ambulante është ndërtuar vite më parë dhe asnjëherë nuk e ka pasur rëndësinë e saj dhe si pasojë tani ajo ambulante është jo funksionale, tani ne duhet t'i shikojmë mundësitë që asaj ambulante të ia ndërrojmë destinimin qoftë si objekt për qëndrim ditor për personat e moshuar apo do t'i japim një orientim tjetër. Sa i përket varrezave dhe

mirëmbajtjes së tyre ne kemi shpallur një tender për këtë çështje por fatkeqësisht këtë tender e ka fituar një kompani e pa përgjegjshme të cilës ia kemi shkëputur kontratën dhe e kemi futur në listën e zezë të operatorëve ekonomik për arsye se nuk e ka kryer punën për të cilën është kontraktuar. Sa i përket Parkut më herët në atë pjesë kemi pasur probleme me taksitë ilegale problem ky që është zgjedhur, mirëpo njerëz të pa ndërgjegjshëm e shfrytëzojnë këtë pjesë dhe futen në mënyrë ilegale në hapësirën e parkut mirëpo në atë pjesë janë të vendosur koshat e plehrave dhe ndoshta kompania e pastrimit mund të futet mirëpo ne së bashku me DSHPMSh, do t'i shikojmë mundësitë për të bërë një zgjidhje që ta ndërprejmë qasjen për të hyrë në hapësirat e parkut.

z.Mehmet Fazliu, nga Podujeva, theksoi, në qoftë se krijoni kushte më të mira për personat me aftësi të kufizuara këtë e them se unë e kam një vajzë me aftësi të kufizuara, besoni se vetëm dy vite i kam marrë nga 200 € si ndihmë nga ana e komunës kurse tani ka 2 apo 3 vite që për vajzën nuk kam marrë asnjë ndihmë dhe askush nuk interesohet për të. Nesër unë do të vdes, ajo do të mbes në duart e shoqërisë.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, nuk e di se a keni bërë ndonjë kërkesë këtë vit lidhur me këtë çështje.

z.Mehmet Fazliu, nga Podujeva; theksoi, këtë vit nuk kam bërë kërkesë sepse vitin e kaluar më kanë injoruar.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, nuk është mirë të ndiheni i injoruar dhe është dashur që këtë vit ta ripërtëri kërkesën, ne kemi nda këtë vit mjete financiare për këtë kategori ndoshta jo për të gjitha kërkesat por e di që kemi ndarë shuma të caktuara për me ua lehtësuar sado pak jetën këtyre personave.

z.Ademi Hoti nga fshati Revuç; theksoi, kërkesën time po e dorëzoj në formë të shkruar sepse edhe më parë ua kam dorëzuar një kërkesë në DSHPMSh.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, i nderuar ky takim është publik me qytetarë dhe ka të bëjë me çështjet e përgjithshme dhe jo me kërkesat individuale mirëpo në këtë rast ju lutem na e dorëzoni edhe kërkesën e juaj.

z.Besmir Jaha, nga fshati Ballofc, paraqiti kërkesë;

-Për emërimin e një rruge në fshatin Ballofc me emrin e dëshmorit "Ali Jaha" në lagjen e Reçicëve. Theksoi, ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga ana e Komunës, andaj nga ana juaj kërkojmë që të vendoset ajo tabelë dhe t'i bëni nder familjes.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; theksoi, ju njoftoj se komisioni komunal i ngritur nga Asambleja komunale në mandatin e kaluar nuk ka qenë funksional, nuk e di se cilat janë arsyet, tani ne në këtë përbërje të re të Asamblesë komunale do ta formojmë komisionin e ri që do t'i shqyrtojë të gjitha ankesat e qytetarëve ku numri i tyre është rreth 350 të parashtruara nga ana e qytetarëve për emërtimin e rrugëve por njëkohësisht do të pranohen dhe analizohen edhe kërkesat e reja për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, andaj ky komision do të ngritet në përbërje konform rregullativës ligjore dhe do të fillojë t'i trajtoj këto probleme. Për fund, meqë nuk ka të interesuar për të marrë fjalën, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë në këtë takim, shpresoj që bashkërisht do t'i trajtojmë të gjitha kërkesat e juaja një nga një dhe t'i japim rrugëdalje gjitha problemeve që ju shqetësojnë ju si qytetarë. Ne me këtë e përmbysim takimin dhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe kontribut.

Takimi përfundoi në ora 12:05

**Procesverbalin e mbajti,
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0109437/21
Podujevë,
20 dhjetor 2021**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**

